



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo			
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije			
Ministry of Finance			
Arkiva - Arhiva - Archive			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit:	04/02	Mr. Prof. Br. Prot. Prot. No:	1100-1/2021
Nr. i faqëve Broj stranica No. pages:	17	Data Datum Date:	29.07.2021
Ministria e Financave			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada – Government**

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -  
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Nr. 401/2021  
Datë: 29.07.2021

Në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, në përputhje me dispozitat e nenit 8, paragrafit 1.4. të Rregullores (QRK) Nr.02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

**V E N D I M**  
**mbi**

**caktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e masës 1.2 - Mbështetja për të Punësuarit e Formalizuar të Pakos së Ringjalljes Ekonomike**

**A. FORMA E SUBVENCIONIMIT**

1. Mbështetja e të Punësuarve të Formalizuar bëhet në formatin si në vijim:

1.1. Subvencionim i kontributit pensional në vlerë prej 10% (dhjetë për qind) të pagës bruto mujore.

1.2. Subvencionimi do të bëhet në baza mujore, për më së shumti 12 muaj, duke filluar nga muaji korrik 2021 deri në muajin qershor 2022.

**B. KRITERI PËR SUBVENCIONIM**

2. Subvencionimi sipas këtij vendimi bëhet vetëm ndaj atyre punonjësve që në muajin qershor të vitit 2021 kanë qenë të papunësuar dhe/ose të padeklaruar për qëllime tatimore në sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës, por që punësohen dhe deklarohen për qëllime tatimore në Administratë Tatimore të Kosovës nga muaji korrik 2021 e tutje.

### **C. KOHËZGJATJA E SUBVENCIONIMIT**

3. Subvencionimi realizohet prej momentit të punësimit dhe deklarimit për qëllime tatimore në sistem të Administratës Tatimore të Kosovës *i.e.*, akti i formalizimit, jo më herët se muaji korrik 2021, dhe gjer në muajin qershor të vitit 2022.

### **D. KUFIZIMET NË SUBVENCIONIM**

4. Subvencionimi për kontributin pensional nuk mund ta tejkalojë shumën 100 (njëqind) Euro për punonjës, pavarësisht pikës 1.1 të këtij vendimi.
5. Subvencionimi për kontributin pensional vlen vetëm për pagën primare.
6. Subvencionimi për kontributin pensional zbatohet deri në 30 (tridhjetë) punonjës të një punëdhënësi. Përgjithësisht, subvencionimi zbatohet deri në 50 (pesëdhjetë) punonjës nëse punëdhënësi punëson punëtorë edhe nga masat e tjera të Masës 1 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

### **E. NDËRPRERJA E SUBVENCIONIMIT**

7. Subvencionimi për punonjësin specifik ndërprehet në momentin e pushimit të marrëdhënies së punës për çfarëdo arsye dhe largimit nga lista e të punësuarve në deklaratën e tatimpaguesit.
8. Subvencionimi ndërprehet në rastin kur punëdhënësi nuk i paguan kontributet pensionale, pavarësisht nëse të njëjtat janë deklaruar në sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës.

### **F. APLIKIMI PËR SUBVENCIONIM**

9. Të drejtë aplikimi kanë shoqëritë tregtare të regjistruara dhe punëdhënësit sipas legjislacionit të Kosovës.
10. Aplikimi bëhet përmes sistemit elektronik EDI të Administratës Tatimore të Kosovës përmes formularit të veçantë që është i qasshëm në EDI.
11. Aplikimi mbetet i hapur deri më 15.10.2021.

### **G. APROVIMI DHE FINALIZIMI I LISTËS SË PËRFITUESVE**

12. Lista finale e të kualifikuarve si përfitues nga masa konfirmohet nga Administrata Tatimore e Kosovës.
13. Mjetet buxhetore të nevojshme për zbatimin e masës do të ndahen me vendim të veçantë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përkatësisht programi Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës.

14. Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, listën finale me shumën totale të aprovuar, pas regjistrimit të shpenzimit në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës e procedon tek Thesari për ekzekutim.

#### **H. ZBATIMI I VENDIMIT PËR SUBVENCIONIM**

15. Pas aprovimit të listës së përfituesve, alokohet buxheti dhe procedohen pagesat e subvencionimit në llogari bankare të punëdhënësit/shoqërisë tregtare.
16. Obligohen Administrata Tatimore e Kosovës, Agjencia e Punësimit e Kosovës dhe Thesari i Kosovës për zbatimin e plotë të këtij vendimi.

#### **I. HYRJA NË FUQI**

17. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ministër i Emancave, Punës dhe Transfereve

Vendimi ju dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të MFPT-së;
- Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit;
- Drejtorit të Përgjithshëm të APRK-së; dhe
- Arkivit.